



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 56 / Prot.,
2

Tiranë më, 22 . 06 . 2023

Memo

Drejtuar: Znj. Erinda Ballanca
Avokati i Popullit

Nëpërmjet: Z. Fatbardh Zenelaj
Sekretar i Përgjithshëm

Përgatiti: Znj. Renisa Tusha
Përgjegjëse e Sektorit të Burimeve Njerëzore

Z. Ilirjan Lole
Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Prokurimeve

Subjekti : Mbi propozimin për disa ndryshime në Urdhrin nr.10, datë 27.01.2023, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit"

Data: 21 qershor 2023

E nderuar znj. Avokate,

Siç jeni në dijeni, me Urdhrin nr.10, datë 27.01.2023, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", është miratuar struktura e re e institucionit në të cilën u pasqyruan veçanërisht ndryshimet e sjella nga ligji nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", ku numri i punonjësve të institucionit shkoi nga 57 (pesëdhjetë e shtatë) në 59 (pesëdhjetë e nëntë) punonjës. Kjo konkretisht për shkak të shtimit të numrit të një ndihmëskomisioneri dhe një specialisti në fushën e teknologjisë së informacionit,

duke respektuar plotësisht standardet në drejtim të formatimit të njësive të strukturës që lidhen me seksionet dhe drejtoritë (sektorët) përkatës.

Mënyra e miratimit të strukturës dhe organikës së institucionit, është parashikuar shprehimisht në nenin 35, paragrafi 3 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në ndryshim nga shumë institucione të pavarura kushtetuese, dhe të institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj, struktura dhe organika e institucionit caktohet nga vetë Avokati i Popullit, çka krijon fleksibilitetin e nevojshëm për t’ju përshtatur në çdo kohë dhe përgjigjur në formën dhe mënyrën e duhur funksioneve e detyrave të institucionit.

Në këtë kuptim, duke parë dhe vlerësuar funksionimin e deri tanishëm të strukturës së institucionit, nevojën e fuqizimit të mëtejshëm të kabinetit ndihmës të Avokatit të Popullit, për të mundësuar lehtësimin dhe mbarëvajtjen më të mirë të punës nga ana e titullarit të institucionit, nga ana juaj është vlerësuar e nevojshme fuqizimi i kësaj strukture aktuale edhe me një këshilltar, çka çon domosdoshmërisht në nevojën e ndryshimit të strukturës ekzistuese.

Kjo, pasi kjo strukturë organizative (kabineti ndihmës) luan një rol të rëndësishëm konsultativ dhe verifikues për problemet dhe fushën e përgjegjësisë që mbulon Avokati i Popullit, si dhe shërben si strukturë filtruese e problemeve administrative. Ai ka nevojë të jetë thelbësisht i fuqizuar, për shkak të rolit në shtuar në rishikimin e rekomandimeve, rritjen e standardit të institucionit, hartimin e *amicus curiae*, si dhe trajtimin e ankesave, në mbështetjeve të seksioneve.

Shtimi me një këshilltar, duke e çuar numrin e tyre në 4 (katër), është plotësisht dhe brenda rregullave të funksionimit të kabineteve ndihmëse, dhe më konkretisht, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave, nr. 893, datë 17.12.2014, “Për miratimin e rregullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm”, ku përcaktohet, ndërmjet të tjerash, se “.....numri i këshilltarëve, përfshirë drejtorin e kabinetit, nuk mund të jetë më shumë se 9 (nëntë) veta...”

Në situatën aktuale, ku në numrin e punonjësve të institucionit, me miratimin e buxhetit të vitit 2023, është shtuar dhe një pozicion “Ndihmëskomisioner” pranë Seksionit të Përgjithshëm, pozicion i cili është i paplotësuar deri më tani, suprimimi i këtij pozicioni pune, mbetet e vetmja zgjidhje e mundshme për të mundësuar fuqizimin e kabinetit ndihmës të Avokatit të Popullit.

Për rrjedhojë, duke vlerësuar punën e çdo seksioni si dhe numrin përkatës të ndihmëskomisionerëve që janë pjesë përbërëse e tyre, suprimimi i këtij vendi nuk do të cenonte thelbësisht punën e Seksionit të Përgjithshëm, së pari pasi kabineti edhe këshilltarët janë pjesë përbërëse e punës së çdo seksioni, por edhe pasi Seksioni i Përgjithshëm ka numrin më të madh të ndihmeskomisionerëve (7), duke pasur në konsideratë ndarjen e fushave të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike të përcaktuar në bazë të urdhrit nr. 154, datë 18.10.2021, si dhe numrin e ankesave që trajtohen nga ndihmëskomisionerët përkatës.

Ndryshimi i dytë që propozohet të behet në strukturën aktuale lidhet me miratimin e vendimeve të Këshillit të Ministrave, nr. 325, datë 31.05.2023, “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi page të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve në disa institucione të


administratës publike”, dhe nr. 326, datë 31.05.2023, “Për pagat e punonjësve mbështetëse dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, si dhe të Udhëzimeve përkatëse të miratuara në bazë dhe për zbatim të tyre nga Ministri Përgjegjës për Financat.

Bazuar në përmbajtjen e këtyre vendimeve kemi një ndryshim të kategorive/klasave të pagave çka do të duhet që të reflektohet dhe në strukturën dhe organikën ekzistuese të institucionit me qëllim përshtatjen e tyre sipas klasave të pagave të përcaktuara në vendimet e mësipërme.

Efektet financiare

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve të mësipërme fillojnë që nga data 1 prill 2023, dhe për periudhën prill-maj do të mbulohen përkohësisht nga buxheti i institucionit të miratuar për vitin 2023 pasi është bërë avancim limiti në shumën prej 6 mil lek, ndërkohë që në vijim fondet që nevojiten për mbulimin e gjithë shpenzimeve të rritjes së pagave në shumën prej 34,600 mijë lek, do të mbulohen nga fondet e kontigjencës së buxhetit të shtetit të miratuar për vitin 2023.

Bashkëlidhur, lutemi, do të gjeni propozimin për disa ndryshime në Urdhrin nr.10, datë 27.01.2023, “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. 56/13 Prot.,

Tiranë më, 22 / 06 / 2023

URDHËR

Nr. 10/1, datë 22 / 06 / 2023

PËR

DISA NDRYSHIME NË URDHËRIN NR. 10, DATË 27.01.2023, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS, ORGANIKËS DHE KATEGORIZIMIT TË POZICIONEVE TË PUNËS TË INSTITUCIONIT TË AVOKATIT TË POPULLIT", I NDRYSHUAR

Mbështetur në nenin 35 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, ligjin nr. 84/2022, datë 24.11.2022, "Për buxhetin e vitit 2023", si dhe në nenin 5 dhe 57 të Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e Institucionit të Avokatit të Popullit,

URDHËROJ:

1. Në Urdhrin nr. 10, datë 27.01.2023, "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit", bëhen ndryshimet si më poshtë:

a. Lidhja nr. 1, organigrama e institucionit të Avokatit të Popullit, zëvendësohet me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij Urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

b. Lidhja nr. 2, organika dhe kategorizimi i pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit. zëvendësohet me të njëjtin numërtim që i bashkëlidhet këtij Urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhri ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKATI I POPULLIT



ERINDA BALLANCA

Lidhja Nr.2

Emërtimi i funksionit	Numri i Punonjësve (59)	Kategoria/Klasa
Avokati i Popullit	1	Ligji nr. 8454, datë 04.02.1999, i ndryshuar
Kabineti	6	
-Drejtor Kabineti	1	I-2
-Këshilltar	4	I-3
-Sekretar	1	Lidhja nr. 5
Sekretar i Përgjithshëm	1	I-1
Seksioni për organet e administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre	7	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	3	I-4
- Ndihmëskomisioner	3	II-1
Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor	5	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	2	I-4
- Ndihmëskomisioner	2	II-1
Seksioni i Përgjithshëm	7	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar
- Ndihmëskomisioner	4	I-4
- Ndihmëskomisioner	2	II-1

Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve	4	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4
- Ndihmëskomisioner	2	
- Ndihmëskomisioner	1	II-1
Mekanizimi për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues	6	
- Komisioner	1	Ligji nr. 8454, datë 4.2.1999, i ndryshuar I-4
- Ndihmëskomisioner	2	
- Ndihmëskomisioner	3	II-1
Drejtoria e Financës, Shërbimeve dhe Pritjes së Qytetarëve	19	
- Drejtor	1	II-1
Spektori i Burimeve Njerëzore		
- Përgjegjës Spektori	1	III-1
- Specialist për Burimet Njerëzore	1	IV-1
- Specialist Protokolli	1	IV-1
- Specialist Arkivist/Bibliotekar	1	IV-1
Spektori i Shërbimeve		
- Përgjegjës Spektori	1	III-1
- Shofer i titullarit	1	Klasa VI
- Shofer	2	Klasa IV
- Teknik i mesëm i specialiteteve të ndryshme	1	Klasa VI
- Punëtor pastrimi	2	Klasa I
Spektori i Financës dhe Prokurimeve		
-Përgjegjës Spektori	1	III-1
-Specialist i Financës	1	IV-1
-Specialist i Prokurimeve	1	IV-1
Spektori i IT dhe Pritjes së Qytetarëve		
- Përgjegjës sektori	1	III-1
- Specialist IT	1	IV-1
- Specialist i Shërbimeve ndaj Qytetarit	2	IV-1
Spektori për bashkëpunimin ndërkombëtar dhe integrimin evropian	3	
- Përgjegjës Spektori	1	III-1
- Specialist	2	IV-1

LIDHJA NR.1

